



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskih sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals



KUVENDI I ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSOR TË KOSOVËS (OIK), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150, nenit 17, paragrafi 4, nenit 18, paragrafi 2 të Statutit të OIK-së, në mbledhjen e mbajtur më _____, miraton këtë:

RREGULLORE

**PËR PROCEDURËN E KANDIDIMIT, ZGJEDHJES DHE SHKARKIMIT
TË ANËTARËVE TË ORGANEVE TË OIK**

KREU I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë dhe të përcaktojë të drejtat zgjedhore, procedurat, kushtet, kriteret e kandidimit, zgjedhjes dhe shkarkimit, si dhe kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve në procesin e zgjedhjeve të brendshme të organeve përfaqësuese të OIK-ut.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet në procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të organeve përfaqësuese të OIK-së, si organe individuale apo kolegjiale, të cilat zgjidhen drejtpërdrejt nga anëtarët e OIK-së apo nga Kuvendi i OIK-ut.

Neni 3

Përkufizimet

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termet e përdorura kanë këto kuptime:

- **“KQZ”** – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përgjegjës për organizimin dhe administrimin e procesit zgjedhor në OIK;
- **“KNJZ”** – Komisioni i Njesisë Zgjedhore, përgjegjës për administrimin e procesit zgjedhor në njësinë zgjedhore;
- **“Kuvend”** – Kuvendi i OIK-së;
- **“Njësi Zgjedhore”** – baza zgjedhore e përfaqësimit të anëtarit në Kuvend;
- **“Lista Votuese”** – lista me të dhënat e anëtarëve të OIK-së që kanë të drejtë vote për Kuvend;
- **“Anëtar”** – anëtar i OIK-së;
- **“Vëzhgues”** – personi i certifikuar nga KQZ për të monitoruar procesin zgjedhor;
- **“Organizatë e akredituar”** – organizatë joqeveritare, si dhe organizata ndërkombëtare të specializuara që merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat akreditohen nga KQZ për monitorimin e procesit zgjedhor për Kuvend;
- **“Libri i Votimit”** – formular, material zgjedhor i aprovuar nga KQZ, në të cilin shënohen vërejtjet lidhur me procesin zgjedhor pranë OIK-së;
- **“Formulari i Përputhjes së Rezultateve (FPR)”** – formulari i miratuar nga KQZ-ja para çdo zgjedhjeje për qëllim të përputhjes së votave në një vendvotim;
- **“Periudha e kundërshtimit dhe e konfirmimit”** – periudha kohore pas shpalljes së listës preliminare të votuesve, gjatë së cilës votuesit me të drejtë vote mund të kundërshtojnë pasaktësitë ose lëshimet në Listën e Votuesve, në vendet e caktuara nga KQZ-ja dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga KQZ-ja;
- **“SKQZ”** – Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- **“Vendvotimi (VV)”** – dhomë, sallë ose objekt i ngjashëm i përcaktuar për qëllim të votimit në Ditën e Zgjedhjeve;
- **“Pezullim i mandatit”** – humbja e përkohshme e të drejtave dhe beneficioneve nga pozita deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar apo vendimmarrjen nga Kuvendi;
- **“Shkarkim i anëtarit”** – mënyra e humbjes së mandatit të anëtarit të organeve, sipas procedurës së përcaktuar me Statutin dhe këtë rregullore.

Neni 4

Shpallja e zgjedhjeve

1. Kuvendi cakton dhe shpall datën e zgjedhjeve për Kuvendin.
2. Zgjedhjet për Kuvend nuk mbahen më herët se gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të mandatit të legjislaturës aktuale, por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas përfundimit të mandatit të përbërjes aktuale.
3. Vendimi i Kuvendit për caktimin e datës së zgjedhjeve merret jo më herët se gjashtë (6) muaj dhe jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë para datës së zgjedhjeve.
4. Kuvendi zgjidhet për mandat katër (4) vjeçar, i cili fillon nga dita e seancës konstitutive, e cila mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve nga shpallja zyrtare e rezultateve të zgjedhjeve.
5. Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve publikohet në faqen zyrtare të internetit të OIK-së.

Neni 5

Zgjedhjet e jashtëzakonshme

1. Zgjedhjet e jashtëzakonshme mbahen dhe organizohen nga KQZ-ja sipas procedurës së zgjedhjeve të rregullta të përcaktuara me këtë rregullore, në afat jo më herët se tridhjetë (30) ditë dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë nga shpërndarja e Kuvendit.
2. Të gjitha afatet dhe procedurat e votimit për zgjedhjet e jashtëzakonshme caktohen nga KQZ-ja.

Neni 6

Parimet themelore

1. Zgjedhjet për Kuvend mbahen në bazë të votës së lirë, të përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë, në përputhje me këtë rregullore dhe Statutin e OIK-së. Votimi i fshehtë nuk zbatohet në rastet kur numri i kandidatëve për t'u zgjedhur është i barabartë me numrin e anëtarëve që zgjedh organi përkatës.
2. Votuesit me të drejtë vote janë të barabartë në ushtrimin e së drejtës së tyre për të votuar.
3. Çdo anëtar ka të drejtë të votojë dhe të zgjidhet pa diskriminim mbi çfarëdo baze, në përputhje me Statutin e OIK-së dhe këtë rregullore.
4. KQZ-ja ndërmerr aktivitete për edukimin e votuesve me qëllim të rritjes së njohurive mbi procedurat e votimit dhe mbrojtjen e të drejtave zgjedhore.
5. Liria dhe fshehtësia e votës janë të garantuara. Askush nuk ka të drejtë të pengojë një anëtar të votojë, ta detyrojë të votojë në një mënyrë të caktuar, ta mbajë përgjegjës për votën ose t'i kërkojë zbulimin e votës apo arsyet e mosvotimit.
6. Zgjedhjet për Kuvend reflektojnë përfaqësimin profesional, institucional dhe nivelet e kujdesit shëndetësor të të gjitha rajoneve të Kosovës.
7. Të gjithë kandidatët, mbështetësit e tyre dhe institucionet e përfshira janë të obliguar të respektojnë parimet themelore të kësaj rregulloreje dhe të kontribuojnë në mbajtjen e zgjedhjeve të lira, të drejta dhe të mirëinformuara, në një atmosferë demokratike, paqësore dhe në respekt të sundimit të ligjit.

KREU II

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Neni 7

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organ i përhershëm i OIK-së, me mandat katër (4) vjeçar dhe i pavarur.
2. KQZ-ja siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me Statutin e OIK-ut dhe rregullat zgjedhore.
3. KQZ përbëhet nga pesë (5) anëtarë, të zgjedhur nga Kuvendi i OIK-ut, me propozimin e Këshillit Drejtues.
4. Përgjegjësitë, puna dhe kompetencat e KQZ-së rregullohen me Rregulloren Zgjedhore për emërimin, përbërjen dhe funksionimin e KQZ-së dhe KNJZ-së.

Neni 8

Njësitë Zgjedhore

1. KQZ certifikon njësitë zgjedhore në të cilat organizohet procesi zgjedhor për Kuvendin e OIK-së.
2. KQZ-ja nxjerr vendim për të përcaktuar:
 - 2.1. qendrat e votimit dhe vendvotimet në njësinë zgjedhore;
 - 2.2. numrin e anëtarëve nga të cilët përbëhet njësia zgjedhore;
 - 2.3. numrin e anëtarëve që njësia zgjedhore zgjedh për Kuvendin e OIK-së.

3. Se në cilën njësi zgjedhore anëtari mund të kandidojë apo të votojë përcaktohet në bazë të vendit të punës, listave të pranuar nga ajo njësi zgjedhore, apo të dhënave nga databaza e anëtarëve të OIK-së.
4. Në rast se njësi zgjedhore, brenda afatit të paraparë nga KQZ-ja, nuk dërgon të dhënat mbi përbërjen e saj për listën preliminare, lista përcaktohet mbi bazën e të dhënave nga databaza e OIK-së, me të dhënat e mëvonshme që vihen në dispozicion.

Neni 9

Komisioni i Njesisë Zgjedhore (KNJZ)

1. Në çdo njësi zgjedhore themelohet Komisioni i Njesisë Zgjedhore.
2. Komisioni i Njesisë Zgjedhore ka tre (3) anëtarë, të cilët janë përgjegjës për administrimin dhe organizimin e zgjedhjeve brenda njesisë zgjedhore.
3. Përbërja, puna dhe përgjegjësitë e KNJZ-ve rregullohen me Rregulloren për emërimin, përbërjen dhe funksionimin e KQZ-së dhe KNJZ-së.

Neni 10

Lokacionet e Vendvotimeve

1. Sipas detyrës zyrtare, apo të mbështetur në rekomandimet e Komisionit të Njesisë Zgjedhore (KNJZ), KQZ-ja, përmes Sekretariatit të KQZ-së, jo më vonë se shtatë (7) ditë para zgjedhjeve, miraton adresën e vendvotimit për njësinë zgjedhore dhe publikon lokacionet e sakta të të gjitha vendvotimeve.
2. Secilit anëtar të regjistruar i caktohet vendvotimi, i cili është lokacioni ku emri i tij/saj figuron në Listën Përfundimtare të Votuesve që përdoret gjatë votimit në ditën e zgjedhjeve.
3. Nëse lokacioni i vendvotimit ndryshohet pas përcaktimit të tij, KQZ-ja i njofton votuesit për ndryshimin përmes formave elektronike.

Neni 11

Plani i veprimit dhe buxheti

1. Plani i Veprimit është akt i miratuar i KQZ-së, me të cilin bëhet konkretizimi i veprimeve dhe aktiviteteve të KQZ-së dhe KNJZ-së.
2. Plani i Veprimit përmban së paku këto elemente:
 - 2.1. procesin e shpalljes së zgjedhjeve, njoftimin dhe publikimin, si dhe përcaktimin e metodologjisë së informimit;
 - 2.2. veprimet që duhet të ndërmerren për sigurimin e Listës së Votuesve dhe veprimet në lidhje me verifikimin e saj;
 - 2.3. oraret për sigurimin e materialit të nevojshëm për veprimet përgatitore të procesit zgjedhor;
 - 2.4. caktimin e kohës dhe afateve për emërimin e anëtarëve të KNJZ-ve dhe procedimin për certifikim nga KQZ-ja;
 - 2.5. mënyrën dhe veprimet e nevojshme për sigurimin e materialit zgjedhor;
 - 2.6. të gjitha çështjet operationale lidhur me përgatitjen, menaxhimin dhe përfundimin e procesit zgjedhor.
3. Plani i Veprimit i miratuar nga KQZ-ja mund të ndryshohet ose plotësohet nga KQZ-ja, sipas nevojave që paraqiten gjatë zhvillimit të procesit zgjedhor.

Neni 12

Mjetet financiare për organizimin e zgjedhjeve

1. OIK siguron mjetet e nevojshme financiare për organizimin e zgjedhjeve, të destinuara për:
 - 1.1. sigurimin e materialit zgjedhor dhe materialeve të tjera shpenzuese;
 - 1.2. pajisjet dhe mjetet teknike të nevojshme për organizimin e zgjedhjeve;
 - 1.3. shpenzimet e rrugës, post-telekomunikacionit dhe shpenzime të tjera;
 - 1.4. kompensimin e anëtarëve të KQZ-së;
 - 1.5. kompensimin e Sekretariatit;
 - 1.6. kompensimin e anëtarëve të KNJZ-së;
 - 1.7. shpenzimet për informim publik;
 - 1.8. angazhimin e personave të tjerë për nevojat e procesit zgjedhor;
 - 1.9. shpenzime të paparashikuara për organizimin e zgjedhjeve, të miratuara nga KQZ-ja.
2. Kompensimi i anëtarëve të KQZ-së, KNJZ-së dhe Sekretariatit përcaktohet nga Këshilli Drejtues, me propozim të Kryetarit të KQZ-së.

KREU III

LISTA VOTUESE

Neni 13

Përmbajtja e listës

1. KQZ-ja mban Listën e Votuesve dhe siguron që Lista e Votuesve të jetë e saktë dhe e azhurnuar. Lista e Votuesve përmban ekstraktin më të fundit në dispozicion të të gjithë anëtarëve të regjistruar si anëtarë të OIK-së, e përpiluar mbi bazën e të dhënave nga njësitet zgjedhore që zhvillojnë zgjedhje për anëtarë të Kuvendit, apo nga databaza e OIK-së në rast se këto institucione nuk e njoftojnë KQZ-në.
2. Në Listën e Votuesve përfshihen të gjithë anëtarët e OIK-së deri në ditën e certifikimit të Listës Votuese.
3. Lista e Votuesve përmban informata si: emrin, mbiemrin, numrin e anëtarësisë, numrin e licencës, numrin personal, njësinë zgjedhore, si dhe elemente të tjera të cilat përcaktohen nga KQZ-ja.
4. Për konfirmimin e të drejtës për votim, KQZ-ja ka qasje në regjistrat e anëtarëve përmes Shërbimit Profesional të OIK-së.
5. Shërbimi Profesional e pajis KQZ-në me të gjitha informatat përkatëse që KQZ-ja i kërkon për mirëmbajtjen e Listës së Votuesve, në pajtim me afatet kohore të caktuara nga KQZ-ja.
6. KQZ-ja u ofron KNJZ-ve një kopje të shtypur të Listës së Votuesve për njësinë e tyre zgjedhore.
7. Çështjet e tjera procedurale lidhur me Listën Votuese rregullohen me rregullore të veçantë për krijimin, kundërshtimin dhe konfirmimin e Listës së Votuesve.

Neni 14

Kriteri i hartimit të Listës Votuese

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bën publikimin përfundimtar të Listës së Votuesve në njësitet përkatëse zgjedhore, të cilat krijohen jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.
2. Lista e Votuesve në njësitet zgjedhore caktohet sipas kriterëve të ushtrimit të veprimtarisë profesionale në institucionin që zgjedh anëtarë të Kuvendit, apo sipas adresës së vendbanimit në rastet e papunësisë.

KREU IV

PËRFAQËSIMI, KANDIDIMI DHE ZGJEDHJET PËR KUVEND

Neni 15

Çelësi përfaqësues në Kuvend

1. Kuvendi i Odës është organi më i lartë përfaqësues dhe rregullativ i Odës, i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga anëtarët e Odës në njësitë zgjedhore të parapara me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

1.1. Institucionet publike të nivelit parësor të kujdesit shëndetësor, në çdo shtatëdhjetë e pesë (75) anëtarë të regjistruar, zgjedhin një (1) anëtar, duke siguruar përfaqësim të të gjitha njësive të nivelit parësor.

1.1.1. Në çdo rast kur numri i anëtarëve tejkalon masën prej gjashtëdhjetë për qind (60%) të çelësit përfaqësues, njësia zgjedhore fiton mandatin tjetër. Ky kriter përdoret vetëm në rast se njësia zgjedhore, sipas çelësit nga paragrafi 1.1 i këtij neni, ka fituar vetëm një (1) anëtar.

1.2. Shërbimi i Qendrës së Mjekësisë Urgjente në Prishtinë është njësi e veçantë zgjedhore.

1.3. Institucionet publike të nivelit dytësor shëndetësor, në çdo gjashtëdhjetë (60) anëtarë të regjistruar, zgjedhin një (1) anëtar për Kuvendin e OIK-ut.

1.3.1. Në çdo rast kur numri i anëtarëve tejkalon masën prej gjashtëdhjetë për qind (60%) të çelësit përfaqësues, njësia zgjedhore fiton mandatin tjetër. Ky kriter përdoret vetëm në rast se njësia zgjedhore, sipas çelësit nga paragrafi 1.3 i këtij neni, ka fituar vetëm një (1) anëtar.

1.4. Institucionet publike të nivelit tretësor shëndetësor, në çdo gjashtëdhjetë (60) anëtarë të regjistruar, zgjedhin një (1) anëtar për Kuvendin e OIK-ut. Të gjitha klinikat e QKUK-së janë njësi të veçanta zgjedhore. Njësitë zgjedhore në QKUK që kanë më pak se pesëdhjetë për qind (50%) të çelësit përfaqësues të anëtarëve fuzionohen ndërmjet vete deri në përmbushjen e kriterit.

1.4.1. Në çdo rast kur numri i anëtarëve tejkalon masën prej shtatëdhjetë për qind (60%) të çelësit përfaqësues, njësia zgjedhore fiton mandatin tjetër. Ky kriter përdoret vetëm në rast se njësia zgjedhore, sipas çelësit nga paragrafi 1.4 i këtij neni, ka fituar vetëm një (1) anëtar.

2. Institucionet e përkujdesjes sociale, institucionet për vuajtjen e dënimit, Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), Policia dhe institucionet e tjera nga kjo kategori ku ofrohen shërbime shëndetësore, të përcaktuara me vendim të KQZ-së, delegojnë nga një (1) anëtar.
3. Institucionet private shëndetësore të të gjitha niveleve të kujdesit shëndetësor përfaqësohen me tridhjetë (30) anëtarë në Kuvend. KQZ-ja, me vendim të veçantë, përcakton kriteret e zgjedhjes/delegimit, duke siguruar përfaqësim të të gjitha niveleve të sektorit privat dhe të të gjitha profileve të OIK-së, mbi bazën e anëtarëve të anëtarësuar në OIK.
4. Anëtarët e papunësuar votojnë në kuadër të njësive të veçantë zgjedhore në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Qendrat e votimit caktohen në Spitalet Rajonale, sipas listës së krijuar gjatë afatit të regjistrimit të shpallur nga KQZ-ja. Çelësi përfaqësues për të papunët është që në çdo njëqind e njëzet (120) anëtarë të regjistruar të zgjidhet një (1) anëtar.

4.1. Në rast të mospërbushjes së kriterit përfaqësues, KQZ-ja nxjerr vendim të veçantë për formulën përfaqësuese të tyre në Kuvend.

4.2. Afati i regjistrimit është i barasvlershëm me afatin e deklarimit të anëtarëve nga njësitë zgjedhore publike.

5. Psikologët klinikë, logopedët dhe ergoterapistët zgjedhen në njësi të veçanta zgjedhore, të cilat themelohen në një njësi të vetme për tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe për të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, me çelës përfaqësues që në çdo pesëdhjetë (50) anëtarë të regjistruar të zgjidhet një (1) anëtar.

5.1.1. Në çdo rast kur numri i anëtarëve tejkalon masën prej shtatëdhjetë për qind (60%) të çelësit përfaqësues, njësia zgjedhore fiton mandatin tjetër. Ky kriter përdoret vetëm në rast se njësia zgjedhore, sipas çelësit nga paragrafi 5 i këtij neni, ka fituar vetëm një (1) anëtar.

6. Me qëllim të formimit më të lehtë të njësive zgjedhore, lejohet shmangia nga kriteret e përcaktuara më lart për përcaktimin e numrit të anëtarëve që zgjedh çdo njësi zgjedhore në masën $\pm 10\%$.

Neni 16

Procedura për kandidim

1. Çdo anëtar i Odës deri në ditën e zgjedhjeve gëzon të drejtën të kandidojë dhe të zgjidhet anëtar i Kuvendit të Odës, në përputhje me Statutin dhe këtë rregullore, me përjashtim të anëtarëve të cilët:

1.1. Janë të dënuar me vendim të formës së prerë me tërheqje të përkohshme të licencës për së paku një (1) vit, gjatë pesë (5) viteve të fundit;

1.2. Janë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë për shkelje të detyrës zyrtare dhe rrezikim të shëndetit publik;

1.3. Janë anëtarë të KQZ-së ose anëtarë të KNJZ-së.

2. Kandidatura për anëtar të Kuvendit duhet të mbështetet me nënshkrim nga së paku pesë (5) anëtarë brenda njësisë përkatëse zgjedhore të kandidatit.

3. Mbledhja e nënshkrimeve bëhet në formularin e përcaktuar nga KQZ-ja.

4. Një anëtar mund të mbështesë vetëm një kandidat për anëtar të Kuvendit.

5. Kandidati për anëtar të Kuvendit nuk mund të japë nënshkrim mbështetës për kandidaturën e tij.

6. Afati dhe procedura për paraqitjen e kandidaturës përcaktohen nga KQZ-ja.

Neni 17

Certifikimi i listës së kandidatëve

1. KQZ-ja është autoriteti kompetent që vendos nëse aplikuesi ka përmbushur kriteret e parapara me Statut, këtë rregullore dhe afatet procedurale të përcaktuara nga KQZ-ja. Pas përfundimit të procedurës së kandidimit, KQZ-ja publikon listën preliminare të kandidatëve.
2. Listën përfundimtare të kandidatëve sipas njësive zgjedhore, KQZ-ja e certifikon dhe e publikon jo më larg se dhjetë (10) ditë nga dita e përfundimit të afatit për dorëzimin e kandidaturave.
3. Nga dita e publikimit të listës preliminare të kandidatëve, palët e pakënaqura lidhur me listën e certifikuar të kandidatëve për Kuvendin e OIK-së mund të paraqesin kërkesë për rishqyrtim në afat prej dyzet e tetë (48) orësh nga ora e publikimit dhe njoftimit përmes emailit. Kërkesa parashtrohet pranë KQZ-së, e cila e shqyrton kërkesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orësh nga ora e pranimit të saj.
4. Ndaj vendimit të KQZ-së me të cilin është trajtuar kërkesa për rishqyrtim, aplikuesi ka të drejtë ankese në shkallë të dytë në Gjyqin e Nderit.
5. Pas kalimit të afateve të ankesave dhe shqyrtimit të tyre, në rast të paraqitjes, KQZ-ja certifikon listën përfundimtare të kandidatëve pjesëmarrës në zgjedhjet për anëtarë të Kuvendit të OIK-së.

KREU V

PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT ZGJEDHOR DHE DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE

Neni 18

Kriteri i radhitjes në Listën e Votuesve

1. Lista e Votuesve paraqet evidencë të anëtarëve të OIK-së me të drejtë vote dhe përpilohet sipas rendit alfabetik të emrave të tyre.
2. Të dhënat nga paragrafi paraprak i këtij neni përpunohen dhe menaxhohen në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
3. Çështjet e tjera procedurale rregullohen me rregullore.

Neni 19

Fletëvotimet

1. KQZ-ja përcakton numrin e fletëvotimeve që shtypen dhe shpërndahen.

2. Fletëvotimi është me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha njësitë zgjedhore.
3. Sasia e fletëvotimeve është deri në dy për qind (2%) më e madhe se numri i anëtarëve në atë njësi zgjedhore.
4. Fletëvotimet për zgjedhjet përgatiten nga KQZ-ja dhe duhet të përmbajnë elemente sigurie sipas përcaktimeve me akt normativ të KQZ-së.
5. Fletëvotimet shtypen nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të KQZ-së ose të Sekretariatit të KQZ-së.
6. Përmbajtja dhe çështjet e tjera lidhur me fletëvotimin rregullohen me rregullore të veçantë.

Neni 20

Distribuími dhe përdorimi i Listës së Votuesve

1. Pas certifikimit të Listës së Votuesve, KQZ-ja siguron për secilën KNJZ Listën e Votuesve për Njësinë përkatëse Zgjedhore.
2. KNJZ-të disponojnë vetëm pjesën e Listës së Votuesve në të cilën përfshihen anëtarët me të drejtë vote në njësinë përkatëse zgjedhore.
3. Listat e Votuesve për secilën Njësi Zgjedhore u distribuohen KNJZ-ve përmes Sekretariatit të KQZ-së. Sekretariati i KQZ-së është i obliguar që Listat e Votuesve për Njësitë Zgjedhore t'ua dërgojë KNJZ-ve në afat jo më të largët se njëzet e katër (24) orë para hapjes së vendvotimit.
4. Nga momenti i dorëzimit të Listës së Votuesve për Njësinë Zgjedhore përkatëse, përgjegjësia për ruajtjen e saj i takon kryesuesit të KNJZ-së.
5. Detajet e tjera të Listës Votuese dhe procedurat përkatëse rregullohen me rregullore të veçantë.

Neni 21

Trajnimi dhe shpërndarja e materialit zgjedhor

1. KQZ-ja organizon trajnim për anëtarët e KNJZ-ve lidhur me rregullat zgjedhore dhe organizimin e procesit zgjedhor.
2. Trajnimi mbahet së paku njëzet e katër (24) orë para ditës së zgjedhjeve. Ditën e trajnimit bëhet edhe dorëzimi i materialeve zgjedhore te KNJZ-të.
3. Me rastin e dorëzimit të materialeve nga Kryesuesi i KQZ-së dhe Kryesuesi i KNJZ-së, apo nga personat e autorizuar nga ta, nënshkruhet procesverbal, i cili përmban të dhënat për materialet e dorëzuara, si në vijim:
 - 3.1. Lista e Votuesve;
 - 3.2. Numri i fletëvotimeve të dorëzuara;
 - 3.3. Libri i votimit;
 - 3.4. Kutia e votimit;

- 3.5. Materiale të tjera si: flika, FPR etj.;
- 3.6. Materiale shpenzuese si: stilolapsë, ngjitës etj.;
- 3.7. Materiale të tjera të përcaktuara nga KQZ-ja;
- 3.8. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet edhe KNJZ-së përkatëse.

KREU VI

MENAXHIMI I VENDVOTIMEVE GJATË PROCESIT ZGJEDHOR

Neni 22

Përgatitja e vendvotimit, hapja dhe mbyllja

1. Në Ditën e Zgjedhjeve, Kryesuesi i KNJZ-së i dërgon materialet për mbajtjen e zgjedhjeve në vendvotim.
2. Të gjithë anëtarët e KNJZ-së duhet të jenë të pranishëm në vendvotim së paku një (1) orë para fillimit të votimit.
3. Komisionerët e KNJZ-ve janë përgjegjës për përgatitjen teknike të vendvotimeve nëpër Njësitë Zgjedhore.
4. Çdo anëtar që gjendet në rresht në orën e mbylljes së vendvotimit lejohet të votojë, nëse ka të drejtë vote. Kontrolluesi i rreshtit e informon personin e fundit në rresht se ai/ajo është personi i fundit që voton. Çdo person tjetër që i bashkohet rreshtit pas këtij personi nuk lejohet të hyjë në vendvotim dhe informohet për pamundësinë e tij/saj për të votuar.
5. Pasi të votojë personi i fundit në rresht në kohën e përfundimit të votimit, Kryesuesi i KNJZ-së e mbyll vendvotimin, e mbyll kutinë e votimit në atë mënyrë që kjo të mund të shihet nga vëzhguesit e pranishëm dhe në Librin e Votimit shënon kohën e saktë të mbylljes.
6. Çështjet e tjera që lidhen me menaxhimin e vendvotimit rregullohen me rregulloren për menaxhimin e vendvotimit.

KREU VII

MENAXHIMI I PROCESIT TË VOTIMIT

Neni 23

Procesi i votimit

1. Votimi është personal dhe realizohet në fletëvotim, duke shenjëzuar emrin e kandidatit që zgjidhet në Kuvendin e Odës.
2. Votuesi ka të drejtë të votojë vetëm për një (1) kandidat.
3. Votuesi, me hyrjen në vendvotim, është i obliguar të dëshmojë identitetin e tij për verifikimin e të drejtës së votës në Listën e Votuesve, përmes njërës nga dokumentet në vijim:
 - 3.1. Letërnjoftimi i vlefshëm;
 - 3.2. ID-kartela e OIK-së;
 - 3.3. Pasaporta valide;
 - 3.4. Leja e vozitjes e vlefshme.
4. Procedurat e tjera për realizimin e të drejtës së votimit përcaktohen me rregulloren zgjedhore për votimin, numërimin në vendvotim dhe menaxhimin e vendvotimit.

Neni 24

Sanksionimi penal

Votimi në të njëjtat zgjedhje më shumë se një herë përbën veprë penale dhe është i dënueshëm në përputhje me Kodin e Etikës sipas kësaj rregulloreje, si dhe me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Neni 25

Rendi dhe rregulli në vendvotim

1. Kryesuesi i vendvotimit kujdeset që në vendvotim të sigurohet rendi dhe rregulli, në kuptim të respektimit të procedurave dhe të përmbajtjes së pjesëmarrësve në procesin zgjedhor, duke parandaluar veprimet e ndaluara sipas rregullimit të përcaktuar nga KQZ-ja.
2. Prishja e rendit, e qetësisë dhe pengesat e bëra gjatë procesit zgjedhor konsiderohen shkelje të rënda të etikës profesionale.
3. Rendi dhe rregulli në vendvotim rregullohen me rregullore të veçantë.

Neni 26

Libri i Votimit

1. Libri i Votimit është formë e përcaktuar nga KQZ-ja, në të cilën shënohen vërejtjet dhe ngjarjet e rëndësishme që ndërlidhen me procesin zgjedhor në vendvotimin përkatës gjatë ditës së zgjedhjeve.
2. Libri i Votimit mirëmbahet dhe ruhet ekskluzivisht nga Kryesuesi i vendvotimit.
3. Në Librin e Votimit të drejtën për të shënuar vërejtje kanë komisionerët dhe vëzhguesit e akredituar.
4. Në çdo rast kur votuesi paraqet vërejtje lidhur me procesin e votimit, Kryesuesi është i obliguar ta shënojë deklaratën e tij/saj dhe, pasi t'ia lexojë deklaratën e shënuar, ta nënshkruajë atë së bashku me votuesin që ka paraqitur vërejtjen.
5. Libri i Votimit është material zgjedhor dhe, si i tillë, duhet të dorëzohet në KQZ së bashku me materialin tjetër përcjellës zgjedhor.
6. Administrimi i këtij libri rregullohet me rregullore të veçantë.

KREU VIII

PROCESI I NUMËRIMIT TË VOTAVE

Neni 27

Numërimi i votave

1. Pas mbylljes së vendvotimit, Kryesuesi i vendvotimit u tërheq vërejtjen vëzhguesve që të mos e lëshojnë vendvotimin deri në përfundimin e procesit të numërimit të votave. Në rast se ndonjëri nga ta e lëshon vendvotimin, Kryesuesi i njofton se nuk do të lejohet hyrja e tyre e sërishme në vendvotim.
2. Numërimi i votave bëhet menjëherë pas mbylljes së vendvotimit.
3. Procedura e numërimit të votave rregullohet me rregullore të veçantë.

Neni 28

Përmbyllja e procesit të numërimit

1. Pas numërimit të votave dhe përmbylljes së procesverbalit të procesit të përgjithshëm (FPR) dhe procesverbalit për votat e kandidatëve (FRK), të cilët nënshkruhen nga Kryesuesi dhe komisionerët e KNJZ-së, fletëvotimet e vlefshme diferencohen nga fletëvotimet e dëmtuara dhe ato të pavlefshme. Fletëvotimet e dëmtuara dhe të pavlefshme futen në zarf të veçantë.

2. Rezultatet e numërimit në KNJZ vendosen në vendvotim nga Kryesuesi i KNJZ-së, ndërsa një kopje tjetër dërgohet në KQZ.
3. KQZ-ja, pas pranimit të materialit zgjedhor nga Sekretariati i KQZ-së, fillon procesin e verifikimit dhe përmbledhjes së rezultateve nga KNJZ-të.
4. Materiali zgjedhor duhet t'i dorëzohet Sekretariatit të KQZ-së jo më vonë se ora 23:59 e ditës së zgjedhjeve. Përgjashtimisht, KQZ-ja, për raste të jashtëzakonshme, mund ta shtyjë këtë afat.

KREU XIX

CERTIFIKIMI DHE SHPALLJA E REZULTATIT ZGJEDHOR

Neni 29

Certifikimi dhe shpallja e rezultatit

1. Pasi të jenë mbledhur të dhënat nga procesverbalet e KNJZ-ve, KQZ-ja konfirmon kandidatët që kanë fituar më së shumti vota në kuadër të Njesisë Zgjedhore. Kandidatët që kanë marrë më së shumti vota, sipas bazës së konstatuar delegeuse nga KQZ-ja, konsiderohen se kanë fituar mandatin zgjedhor.
2. Në rast se dy apo më shumë kandidatë kanë numër të barabartë votash për fitimin e mandatit, në prani të KQZ-së hidhet shorti, sipas të cilit konstatohet fituesi i mandatit.
3. KQZ-ja, pasi ta ketë përfunduar procesin e evidentimit të mandateve, krijon listën unike të kandidatëve që kanë fituar mandatin. Kjo listë materializohet nga Sekretariati i KQZ-së dhe procedohet për certifikim në mbledhjen e thirrur nga Kryesuesi i KQZ-së.
4. KQZ-ja e certifikon rezultatin zgjedhor jo më larg se pesë (5) ditë nga dita e zgjedhjeve.

Neni 30

Ankimimi në procesin zgjedhor

1. Secili kandidat që ka marrë pjesë në procesin zgjedhor ka të drejtë të parashtojë ankesë lidhur me parregullsitë e procesit zgjedhor.
2. Palët e pakënaqura me rezultatin e publikuar mund të paraqesin kundërshtimin e tyre pranë KQZ-së në afat prej njëzet e katër (24) orësh nga mbyllja e votimit.
3. Parashtrimi i kundërshtimit e pezullon procesin e certifikimit të rezultatit përfundimtar deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të KQZ-së.
4. KQZ-ja vendos për ankesat e parashtruara me vendim përmes të cilit:

- 4.1. aprovon ankesën dhe ndërmerr hapa për përmirësimin e rezultatit sipas gjetjeve të konstatuara;
 - 4.2. aprovon ankesën si të bazuar dhe urdhëron rinumërimin e vendvotimit;
 - 4.3. aprovon ankesën dhe urdhëron rivotimin në vendvotimin e caktuar;
 - 4.4. hedh poshtë ankesën si të pabazuar apo të palejuar.
5. Pala e pakënaqur me vendimin e KQZ-së ka të drejtë ankese në afat prej dyzet e tetë (48) orësh nga njoftimi i vendimit, në Gjyqin e Nderit si organ i shkallës së dytë, i cili vendos brenda dyzet e tetë (48) orësh nga pranimi i ankesës.
 6. Gjyqi i Nderit, në procesin e ankesës, mund të vendosë në përputhje me veprimet e KQZ-së nga ky nen.
 7. Vendimi i Gjyqit të Nderit është përfundimtar.

Neni 31

Certifikimi i rezultateve përfundimtare për Kuvendin

1. Procesi zgjedhor për Kuvendin e OIK-ut konsiderohet i përfunduar me shpalljen e rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, pasi të kenë përfunduar afatet e ankesave apo pasi të jetë vendosur për këto ankesa.
2. KQZ-ja i publikon rezultatet e zgjedhjeve përfundimtare në ueb-faqe. Sekretariati i KQZ-së i publikon këto rezultate përfundimtare në formë tabelare, duke përfshirë edhe publikimin në faqen e vet të internetit, si në vijim:
 - 2.1. numrin e zgjedhësve të regjistruar;
 - 2.2. numrin e zgjedhësve që kanë votuar në secilën njësi zgjedhore;
 - 2.3. numrin e përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar;
 - 2.4. numrin e fletëvotimeve të vlefshme;
 - 2.5. numrin e fletëvotimeve të papërdorura;
 - 2.6. numrin e fletëvotimeve të përdorura;
 - 2.7. numrin e fletëvotimeve të pavlefshme;
 - 2.8. numrin e fletëvotimeve të zbrazëta;
 - 2.9. numrin e fletëvotimeve të dëmtuara;
 - 2.10. numrin e votave për secilin kandidat;
 - 2.11. emrat e kandidatëve të zgjedhur.

KREU X

ZGJEDHJA E KRYETARIT DHE ZËVENDËS KRYETARIT TË OIK

Neni 32

Kushtet dhe procedura e kandidimit

1. KQZ shpall zgjedhjet për Kryetar të OIK-ut më së voni pesë (5) ditë pas ditës së certifikimit të rezultatit zgjedhor.
2. Dorëzimi i formularëve për kandidim, së bashku me CV-në, bëhet në KQZ për certifikim, i cili realizohet brenda shtatë (7) ditëve nga dita e shpalljes së zgjedhjeve.
3. Secila kandidaturë për Kryetar të OIK-ut duhet të mbështetet me nënshkrimet e njëzet (20) anëtarëve të Kuvendit të OIK-së. Kandidati nuk mund të japë nënshkrim mbështetës për veten e tij.
4. Çdo anëtar i Kuvendit ka të drejtë të japë nënshkrimin mbështetës vetëm për një (1) kandidaturë.
5. Kandidati për Kryetar të OIK-së nënshkruan deklaratën nën betim në formularin e miratuar nga KQZ-ja.
6. Kandidati për Kryetar duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:
 - 6.1. Të ketë së paku dhjetë (10) vite përvojë pune në fushën e profileve shëndetësore të OIK-ut;
 - 6.2. Të ketë së paku katër (4) vjet përvojë pune menaxheriale;
 - 6.3. Të ketë gradë shkencore apo profesionale, së paku Master profesional, shkencor ose menaxhues në shëndetësi;
 - 6.4. Kandidati për Kryetar duhet të dëshmojë se në katër (4) vitet e fundit nuk është marrë me ndonjë aktivitet politik, përmes deklaratës nën betim. KQZ-ja mund të ndërmarrë hetime shtesë për verifikimin e kësaj deklarate;
 - 6.5. Të mos ketë të shqiptuara shkelje etike nga organet etike të OIK-ut së paku për pesë (5) vitet e fundit, apo dënim për keqpërdorim të detyrës zyrtare si vepër penale apo për vepra kundër shëndetit publik.)
7. KQZ-ja është organi kompetent për vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara me Statutin e OIK-së dhe këtë rregullore.
8. Plotësimi i kërkesave për kandidim për Kryetar, të përcaktuara me këtë rregullore, dëshmohet me rastin e kandidimit përmes dokumenteve, procedurave dhe afateve të përcaktuara nga KQZ-ja.
9. Ndaj vendimit të KQZ-së mund të parashtrohet kërkesë për rishqyrtim të vendimit.
10. Vendimi i KQZ-së ndaj kërkesës për rishqyrtim mund të atakohet në Gjyqin e Nderit.
11. Afatet procedurale nga ky nen caktohen nga KQZ-ja.

Neni 33

Procesi i votimit dhe zgjedhjes së Kryetarit

1. Kryetar i OIK-së zgjidhet kandidati i cili, në raundin e parë të votimit, merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Kuvendit.
2. Në rast se asnjëri nga kandidatët nuk arrin numrin e nevojshëm të votave për t'u zgjedhur në raundin e parë, zhvillohet raundi i dytë ndërmjet dy kandidatëve më të votuar në raundin e parë. Në raundin e dytë, Kryetar i OIK-së zgjidhet kandidati i cili merr një (1) ose më shumë vota se kandidati tjetër nga anëtarët prezentë.
3. Me përfundimin e procesit zgjedhor, KQZ-ja shpall rezultatin e zgjedhjes së Kryetarit të Odës dhe përpilon procesverbal të veçantë, në të cilin evidentohen të gjitha hollësitë e procesit zgjedhor. Formën e këtij procesverbali e miraton KQZ-ja.
4. Mandati i Kryetarit zgjat katër (4) vjet.

Neni 34

Zgjedhja e Zëvendëskryetarëve të OIK-së

Me propozim të Kryetarit të OIK-së, Kuvendi, me shumicë votash të anëtarëve prezentë, zgjedh Zëvendëskryetarët në një votim të hapur

KREU XI

KËSHILLI DREJTUES

Neni 35

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues

1. Jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e zgjedhjes së Kryetarit të OIK-së, bëhet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues të OIK-së.
2. Kryetari dhe dy (2) Zëvendëskryetarët e OIK-së janë anëtarë të Këshillit Drejtues sipas detyrës zyrtare.
3. Kandidatura për anëtarë të Këshillit Drejtues duhet të mbështetet nga së paku dhjetë (10) nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit.
4. Kandidatët për anëtarë të Këshillit Drejtues janë anëtarë të Kuvendit dhe nuk mund të jenë kandidatë edhe për Këshillin Mbikëqyrës.
5. Kandidati për anëtar të Këshillit Drejtues duhet të dëshmojë se në katër (4) vitet e fundit nuk është marrë me ndonjë aktivitet politik, përmes deklaratës nën betim. KQZ-ja do të ndërmarrë hetime shtesë për verifikimin e saj.
6. Një anëtar i Kuvendit mund të mbështesë vetëm një (1) kandidat për Këshillin Drejtues.
7. Votimi për anëtarë të Këshillit Drejtues është i drejtpërdrejtë dhe i fshehtë.
8. Zgjedhja e Kryetarit dhe Zëvendëskryetarit të Këshillit Drejtues, si dhe tre (3) anëtarëve, bëhet nga Kuvendi i OIK-së.
9. Kandidatura për Këshillin Drejtues, së bashku me nënshkrimet përkatëse, dorëzohet në KQZ.

10. Certifikimin e kandidaturave e bën KQZ-ja.
11. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota zgjidhen anëtarë të Këshillit Drejtues.
12. Afatet dhe detajet e tjera procedurale përcaktohen nga KQZ-ja.

KREU XII

KËSHILLI MBIKËQYRËS

Neni 36

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

1. Jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga zgjedhja e Kryetarit të OIK-së, bëhet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës.
2. Këshilli Mbikëqyrës i OIK-së ka Kryetarin, Zëvendëskryetarin dhe tre (3) anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i OIK-së me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidatura për Kryetar, Zëvendëskryetar dhe anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës duhet të mbështetet nga së paku dhjetë (10) nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OIK-së.
4. Një anëtar i Kuvendit mund të mbështesë vetëm një (1) kandidat për Këshillin Mbikëqyrës.
5. Kandidati për Këshillin Mbikëqyrës duhet të jetë anëtar i Kuvendit dhe nuk mund të jetë kandidat edhe për Këshillin Drejtues.
6. Kandidatura, së bashku me nënshkrimet përkatëse, dorëzohet në KQZ.
7. Kandidaturat janë të ndara në Kryetar, Zëvendëskryetar dhe anëtarë.
8. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota zgjidhen në Këshillin Mbikëqyrës.
9. Afatet dhe detajet e tjera procedurale përcaktohen nga KQZ-ja.

KREU XIII

KËSHILLI ETIK

Neni 37

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Etik

1. Jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë nga konstituimi i Kuvendit, bëhet zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Etik.
2. Këshilli Etik i OIK-së ka Kryetarin, Zëvendëskryetarin dhe dy (2) anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i OIK-së me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidaturat për Kryetar, Zëvendëskryetar dhe anëtarë të Këshillit Etik vijnë nga radhët e anëtarëve të Kuvendit dhe duhet të mbështeten nga së paku dhjetë (10) nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OIK-së.
4. Një anëtar i Kuvendit mund të mbështesë vetëm një (1) kandidat për Këshillin Etik.
5. Kandidaturat, së bashku me nënshkrimet përkatëse, dorëzohen në KQZ.
6. Kandidaturat janë të ndara në Kryetar, Zëvendëskryetar dhe anëtarë.
7. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota zgjidhen në Këshillin Etik.
8. Afatet dhe detajet e tjera procedurale përcaktohen nga KQZ-ja.

KREU XIV

GJYQI I NDERIT

Neni 38

Zgjedhja e anëtarëve të Gjyqit të Nderit

1. Jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë nga konstituimi i Kuvendit të OIK-së, bëhet zgjedhja e anëtarëve të Gjyqit të Nderit.
2. Gjyqi i Nderit i OIK-së ka Kryetarin, Zëvendëskryetarin dhe tre (3) anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi i OIK-së me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë.
3. Kandidaturat për Kryetar, Zëvendëskryetar dhe anëtarë të Gjyqit të Nderit vijnë nga radhët e anëtarëve të Kuvendit dhe duhet të mbështeten nga së paku pesë (5) nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OIK-së.
4. Një anëtar i Kuvendit mund të mbështesë vetëm një (1) kandidat për Gjyqin e Nderit.
5. Kandidaturat, së bashku me nënshkrimet përkatëse, dorëzohen në KQZ.
6. Kandidaturat janë të ndara në Kryetar, Zëvendëskryetar dhe anëtarë.
7. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota zgjidhen në Gjyqin e Nderit.
8. Afatet dhe detajet e tjera procedurale përcaktohen nga KQZ-ja.

KREU XV

PROKURORI DHE ZËVENDËSPROKURORI

Neni 39

Zgjedhja e Prokurorit dhe Zëvendësprokurorit

1. Jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë nga konstituimi i Kuvendit të OIK-së, bëhet zgjedhja e Prokurorit dhe Zëvendësprokurorit të OIK-së.
2. Kandidaturat për Prokuror dhe Zëvendësprokuror votohen me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë nga anëtarët e Kuvendit.
3. Kandidatura për Prokuror të OIK-së duhet të mbështetet nga së paku pesëmbëdhjetë (15) nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OIK-së.
4. Kandidatura për Zëvendësprokuror të OIK-së duhet të mbështetet nga së paku dhjetë (10) nënshkrime të anëtarëve të Kuvendit të OIK-së.
5. Një anëtar i Kuvendit mund të mbështesë vetëm një (1) kandidat për Prokuror dhe një (1) kandidat për Zëvendësprokuror të OIK-së.
6. Kandidaturat, së bashku me nënshkrimet përkatëse, dorëzohen në KQZ.
7. Kandidaturat janë të ndara në Prokuror dhe Zëvendësprokuror.
8. Kandidatët që kanë fituar më shumë vota zgjidhen.
9. Afatet dhe detajet e tjera procedurale përcaktohen nga KQZ-ja.

KREU XVI

KOMISIONET E PËRHERSHME TË ODËS

Neni 40

Zgjedhja e Komisioneve të Përherhme dhe të Përkohshme të Odës

1. Anëtarët dhe Kryetarët e komisioneve të përherhme dhe të përkohshme të Odës propozohen nga Këshilli Drejtues dhe propozimi i tillë aprovohet nga Kuvendi i Odës me votim të hapur.
2. Propozimet nga paragrafi 1 i këtij neni konsiderohen të miratuara me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit që janë të pranishëm.

KREU XVII

PËRJASHTIMI I VOTËS SË FSHEHTË

Neni 41

Përfashtimi i votës së fshehtë me rastin e zgjedhjes së organeve nga Kuvendi

Në të gjitha rastet kur numri i kandidatëve të certifikuar për zgjedhje në një pozitë në kuadër të organeve të OIK-së është i barabartë me numrin e pozitave të atij organi, votimi nga Kuvendi bëhet i hapur, me përfashtim të rastit të zgjedhjes së Kryetarit të Odës.

KREU XVIII

SHKARKIMI DHE PEZULLIMI I ANËTARËVE TË ORGANEVE TË ODËS

Neni 42

Zëvendësimi i anëtarëve të cilëve u përfundon mandati para përfundimit të mandatit të rregullt të Kuvendit

1. Në rast se, për cilëndo rrethanë të paraparë me dispozitat e Statutit apo rregulloreve në fuqi, apo për humbje të legjitimitetit përfaqësues për shkak të ndërrimit të njësisë zgjedhore prej së cilës është zgjedhur, anëtarit të Kuvendit i ka pushuar mandati para kohës së skadimit të mandatit të Kuvendit të OIK-së, zëvendësimi i tij/saj do të bëhet nga KQZ-ja.
2. Zëvendësimi do të bëhet me njoftim formal nga Kryetari i OIK-së, si kryesues i Kuvendit të OIK-së.
3. Jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e njoftimit formal nga Kryetari i OIK-së, KQZ-ja bën zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit të cilit i ka pushuar para kohe mandati, duke e konstatuar zëvendësimin e tillë me kandidatin e të njëjtës njësi zgjedhore, me numrin e votave që është renditur pas anëtarit të cilit i ka pushuar mandati.
4. Mandati i anëtarit të ri të Kuvendit zgjat deri në skadimin e mandatit aktual të anëtarëve të zgjedhur në zgjedhjet e rregullta.
5. Në rastet kur në njësinë zgjedhore nuk ka kandidat i cili e pason me vota anëtarin e Kuvendit që duhet të zëvendësohet, KQZ-ja i shpall zgjedhjet në atë njësi zgjedhore dhe mund t'i përgjysmojë afatet e parapara me këtë rregullore sa i përket procedurave zgjedhore të parashikuara me këtë rregullore.
6. Të gjitha dispozitat e kësaj rregulloreje janë të zbatueshme përshtatshmërisht me rastin e zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit, lidhur me organizimin e procesit zgjedhor në mënyrë të veçantë në njësitë përkatëse zgjedhore.
7. Në rast të humbjes së mandatit të anëtarit të Kuvendit, i njëjti humb mandatin edhe nga organet e OIK-së në të cilat ka kandiduar dhe është zgjedhur nga Kuvendi i OIK-së.

Neni 43

Inicimi i kërkesës për revokim të anëtarit të Kuvendit

1. Secili anëtar nga njësia zgjedhore e cila e ka zgjedhur anëtarin e Kuvendit ka të drejtë të ndërmarrë iniciativën për shkarkimin e anëtarit të Kuvendit nga ajo njësi zgjedhore, në përputhje me Statutin dhe këtë rregullore.
2. Kërkesa e anëtarëve për shkarkimin e mandatit të anëtarit nga Kuvendi i Odës duhet të nënshkruhet nga 1/3 e anëtarëve të njësisë përkatëse zgjedhore.
3. Mbledhja e nënshkrimeve duhet të bëhet mbi bazën e vullnetit të lirë të anëtarëve. Ndalohet ushtrimi i çfarëdo presioni apo ndikimi që imponon, kushtëzon apo detyron anëtarët të nënshkruajnë pa vullnetin e tyre, apo nënshkrimi në emrin e tyre.

4. Inicimi i kërkesës për shkarkim mund të bëhet për këto arsye:
 - a. Mospërfaqësim i dinjitetshëm i interesave të anëtarëve të asaj njësie zgjedhore;
 - b. Shkelje të rënda etike.

Neni 44

Inicimi i procedurës

1. Anëtarët e njësisë zgjedhore të interesuar për iniciimin e procedurës së largimit të anëtarit të Kuvendit nga ajo njësi zgjedhore duhet të themelojnë një grup nismëtar. Grupi nismëtar përbëhet nga tre (3) ose më shumë anëtarë me të drejtë vote në atë njësi zgjedhore.
2. Grupi nismëtar, para se të fillojë me mbledhjen e nënshkrimeve në mbështetje të kërkesës, duhet të njoftojë Kryetarin e OIK-së. Kryetari i OIK-së njofton KQZ-në. Njoftimi përfshin përbërjen e grupit nismëtar, definimin e çështjes dhe arsyetimin e kërkesës.
3. Jo më vonë se pesë (2) ditë nga regjistrimi i grupit nismëtar, Kryetari i OIK-së kërkon nga KQZ numrin e përditësuar të votuesve të regjistruar për njësinë përkatëse zgjedhore, mbi bazën e të cilit përlllogaritet numri minimal i nevojshëm i nënshkrimeve prej 1/3 e anëtarësisë së asaj njësie zgjedhore.
4. Numri minimal prej 1/3 e anëtarëve nënshkrues llogaritet sipas numrit të përgjithshëm të votuesve në listën e përditësuar të njësisë përkatëse zgjedhore, që mban datën e njoftimit në kërkesë.
5. Jo më vonë se pesë (7) ditë nga regjistrimi i grupit nismëtar, Shërbimi Profesional i OIK-së e pajis grupin nismëtar me dokumentacionin e nevojshëm. Dokumentacioni përfshin listën e nënshkrimeve në formatin e përcaktuar nga KQZ, si dhe listën e votuesve të aprovuar nga KQZ që përfshin listën deri në datën e paraqitjes së kërkesës, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe me numrin minimal të nevojshëm për këtë proces.
6. Lista e nënshkrimeve, sipas paragrafit 5 të këtij neni, përmban në secilën faqe të saj të dhënat si në vijim:
 - 6.1. Titullin e kërkesës;
 - 6.2. Çështjen për të cilën mbledhen nënshkrimet;
 - 6.3. Tabelën me këto të dhëna:
 - 6.3.1. Emrin;
 - 6.3.2. Mbiemrin;
 - 6.3.3. Numrin personal;
 - 6.3.4. Kodin e licencës;
 - 6.3.5. Numrin e telefonit;
 - 6.3.6. Nënshkrimin.
7. Për mbledhjen e nënshkrimeve, grupi nismëtar përdor listën e nënshkrimeve sipas formatit të përcaktuar nga KQZ.

Neni 45

Mbledhja, dorëzimi dhe verifikimi i nënshkrimeve

1. Grupi nismëtar, brenda tridhjetë (30) ditëve nga pajisja me dokumentacionin e nevojshëm, duhet të mbledhë numrin e kërkuar të nënshkrimeve. Ky afat mund të shtyhet vetëm një herë, me kërkesë të grupit nismëtar, edhe për pesëmbëdhjetë (15) ditë të tjera.
2. Nënshkrimet mblidhen në format fizik.
3. Një anëtar që ka nënshkruar në listën inicuese mund ta tërheqë nënshkrimin e tij, përmes deklaratës me shkrim në mënyrë fizike, së bashku me arsyetimin e tërheqjes, jo më larg se brenda shtatë (7) ditëve nga dorëzimi i listës nga grupi inicues, apo brenda njëzet e katër (24) orëve nga njoftimi i KQZ-së që i është bërë për verifikim të listës.
4. Grupi nismëtar përgatit dosjen e kërkesës me nënshkrime dhe ia dorëzon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. KQZ verifikon listën e nënshkrimeve brenda tetë (8) ditëve nga pranimi i saj. Pas verifikimit të nënshkrimeve, KQZ njofton Kryetarin e OIK-së dhe grupin nismëtar jo më larg se tre (3) ditë nga përfundimi i vlerësimit, me vlerësimin përfundimtar për validitetin e kushtit të nënshkrimeve dhe kushtet për mbajtjen e procesit për shkarkimin e mandatit.
6. Verifikimi i listës nga KQZ bëhet nga Sekretariati, përmes thirrjes telefonike të anëtarit nënshkrues, apo deklaramit me email.
7. Nëse nga verifikimi i listës me nënshkrime KQZ konstaton se nuk është plotësuar numri minimal prej 1/3 të votuesve të regjistruar, atëherë KQZ njofton grupin nismëtar, të cilit i jepet mundësia e plotësimit të kërkesës me nënshkrime në afatin shtesë prej dhjetë (10) ditësh. KQZ për afatin shtesë e njofton Kryetarin e OIK-së.
8. Nëse edhe pas afatit shtesë për plotësimin e numrit të nënshkrimeve nuk përmbushet kushti prej së paku 1/3 të votuesve të regjistruar, KQZ konstaton se kërkesa nuk është mbështetur nga numri i nevojshëm i votuesve dhe konsiderohet e pavlefshme. Për këtë, KQZ njofton grupin nismëtar dhe Kryetarin e OIK-së.
9. Pas verifikimit dhe konstatimit se kërkesa është mbështetur nga së paku 1/3 e anëtarëve të regjistruar, KQZ njofton grupin nismëtar dhe Kryetarin e OIK-së.
10. Në rast se konstatohet se kërkesa është mbështetur nga së paku njëzet 1/3 e anëtarëve të regjistruar, organizohet votimi për largimin e anëtarit të Kuvendit nga detyra, i cili vjen nga ajo njësi zgjedhore.

Neni 46

Organizimi i procesit të votimit

1. Pas konstatimit të plotësimit të numrit të nënshkrimeve për inicim të procedurës për shkarkimin e mandatit të anëtarit të Kuvendit, organizohet procesi zgjedhor për deklaramit të anëtarëve.
2. Në procesin zgjedhor, anëtarët deklarohen në pyetjen: “Deklarohuni nëse mbështetni iniciativën e grupit inicues për shkarkimin e mandatit të z. _____, nga pozita e anëtarit të Kuvendit të OIK-së, nga njësia e juaj zgjedhore.”

3. Anëtari mund të zgjedhë një nga tri alternativat e përgjigjes: a) PËR; b) KUNDËR; c) ABSTENIM.
4. Procesi i votimit organizohet përshtatshmërisht me rregullat për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme.
5. Mandati i anëtarit të Kuvendit konsiderohet i revokuar në rast se për shkarkimin e tij kanë votuar PËR $\frac{1}{2} + 1$ anëtarë të certifikuar në listën votuese për këtë proces.
6. Anëtarit të revokuar nga njësia përkatëse zgjedhore i pushon anëtarësimi në organet e Odës së Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të Tjerë Shëndetësor të Kosovës.
7. Anëtari i revokuar zëvendësohet nga anëtari pasues i mbetur në listën e certifikuar të rezultateve në zgjedhjet e rregullta të mbajtura për Kuvendin e OIK-së.
8. Në rast se nuk ka asnjë kandidat të mbetur në radhë, organizohet proces i ri zgjedhor për atë vend të mbetur në njësinë zgjedhore, përshtatshmërisht me dispozitat për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme.

Neni 47

Shkarkimi i mandatit të Kryetarit të OIK-së

1. Kuvendi i OIK-së, me votat e $\frac{2}{3}$ të anëtarëve të tij, mund ta shkarkojë Kryetarin e OIK-së para përfundimit të mandatit për rastet si:
 - a. Është dënuar me aktgjykim të formës së prerë me dënim me burgim prej jo më pak se gjashtë (6) muaj;
 - b. Humb zotësinë e veprimit;
 - c. Është në gjendje të rëndë shëndetësore, si pasojë e së cilës nuk mund ta ushtrojë funksionin për më shumë se gjashtë (6) muaj;
 - d. Dënohet me vendim përfundimtar për shkelje të rënda etike nga organet etike të OIK-së.

Neni 48

Shkarkimi i mandatit të Zëvendëskryetarëve të OIK-së

Kuvendi i OIK-së mund të shkarkojë Zëvendëskryetarët e OIK-së, pas propozimit të Kryetarit të OIK-së, me shumicën e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.

Neni 49

Shkarkimi i anëtarëve të organeve të OIK-së

1. Procedura e shkarkimit të anëtarit të organeve iniciohet me kërkesën e Kryetarit të Odës, Këshillit Drejtues, $\frac{1}{2}$ e anëtarëve të organit përkatës, apo me iniciativën e $\frac{1}{3}$ e anëtarëve të Kuvendit të Odës, për shkak të mosefikasitetit ose pengimit të punës së organit.

2. Anëtari i organit të Odës konsiderohet i shkarkuar nëse për këtë kanë votuar shumica e anëtarëve të pranishëm të Kuvendit të Odës.
3. Për shkarkimin e Prokurorit të Odës, iniciimi bëhet nga Këshilli Drejtues.

Neni 50

Shkarkimi i anëtarëve të Komisioneve

1. Kryetari i OIK-së, Kryesuesi i komisionit, apo $\frac{1}{2}$ e anëtarëve të komisionit mund t'i paraqesin Këshillit Drejtues kërkesë për shkarkimin e anëtarëve të komisionit.
2. Kuvendi i OIK-së mund të shkarkojë një anëtar të komisioneve të OIK-së të zgjedhura nga Kuvendi, vetëm me propozimin e Këshillit Drejtues të OIK-së, për arsye të mospërbushjes së detyrimeve ligjore e statutores.
3. Votimi konsiderohet i suksesshëm nëse për të kanë votuar shumica e anëtarëve të Kuvendit të pranishëm në mbledhje.

Neni 51

Pezullimi i anëtarit të organit kolegjal nga funksioni

1. Në rast kur ndaj një anëtari të organeve të OIK-së fillon procedura etike pranë Këshillit Etik, apo procedurë gjyqësore për keqpërdorim të detyrës profesionale apo detyrës zyrtare, Kryetari i OIK-së automatikisht e pezullon nga detyra anëtarin.
2. Në mbledhjen e parë pas pezullimit të anëtarit, Kuvendi i OIK-së vendos nëse i njëjti do të mbetet i pezulluar deri në përfundimin e çështjes etike apo gjyqësore, apo do të shkarkohet dhe në vend të tij të zgjidhet anëtar i tjetër.
3. Fillim i procedurës etike konsiderohet miratimi i fletëparaqitjes ndaj anëtarit në Këshillin Etik.
4. Pezullimi nga detyra nuk paragjykon fajësinë e anëtarit në fjalë.

KREU XIX

PROCEDURAT PËR VËZHGIM, AKREDITIM DHE AUTORIZIMET E VËZHGUESVE

Neni 52

Propozimi i vëzhguesve

1. Organizatat qeveritare dhe ndërqeveritare, organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe me çështje shëndetësore, përfaqësuesit e vendeve të huaja, si dhe secili kandidat që merr pjesë në procesin zgjedhor,

- kanë të drejtë të propozojnë një person në cilësi të vëzhguesit në njësinë zgjedhore në të cilën është certifikuar kandidatura e tij.
2. Kandidati mund ta propozojë vëzhguesin vetëm brenda njësisë zgjedhore në të cilën zgjidhet nga anëtarët e njësisë zgjedhore. Vëzhguesi nuk mund të jetë kandidat për anëtar të Kuvendit.
 3. Organizatat joqeveritare që parashtrojnë kërkesën për akreditim kanë të drejtë të propozojnë nga një përfaqësues në cilësi të vëzhguesit për një vendvotim.
 4. Për të propozuar vëzhguesin, kandidati duhet të parashtrojë kërkesë pranë KQZ-së së bashku me formularin për kandidim, sipas afatit të përcaktuar nga KQZ.
 5. Anëtari i Kuvendit, i cili kandidon për ndonjërin prej organeve të OIK-së, mund ta propozojë një nga anëtarët e Kuvendit për vëzhgim të procesit ku ai kandidon gjatë mbajtjes së asaj mbledhjeje. Rregullat e përcaktuara për vëzhguesit gjatë procesit zgjedhor për Kuvendin e OIK-së janë të barasvlershme edhe për vëzhguesit gjatë procesit të zgjedhjes së organeve që dalin nga Kuvendi i OIK-së.
 6. Çështjet tjera për procedurat vëzhguese dhe të drejtat e vëzhguesve në procesin zgjedhor rregullohen me rregulloren për vëzhguesit e zgjedhjeve.

KREU XX

DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 53

Sanksioni etik

1. Ndaj kandidatëve për anëtarë të organeve të OIK-së, të cilët cenojnë procesin zgjedhor për organet e OIK-së ose nuk respektojnë parimet e përcaktuara me këtë rregullore, shkeljet e tilla do të shërbejnë si bazë për iniciimin e procedurës etike për shkelje të rëndë të detyrimeve.
2. Po ashtu, edhe ndaj anëtarëve votues të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, shkeljet e tilla do të shërbejnë si bazë për iniciimin e procedurës etike për shkelje të rëndë të detyrimeve.
3. Procedura e vërtetimit të shkeljes së pretenduar zbatohet përshtatshmërisht me dispozitat e rregullores për përcaktimin e shkeljeve etike dhe procedurat e mbikëqyrjes etike dhe profesionale të OIK-së.
4. Ndaj rasteve nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni mund të shqiptohet njëra nga masat e parapara (paragrafi 1 me nënparagrafin 6 ose masa në nënparagrafin 7) në nenin 25 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nr. 04/L-150, në varësi nga rrethanat e shkeljes.
5. Shkelja etike nuk konsumon veprën penale.
6. KQZ shërben si organ inicues në Këshillin Etik për shkeljen e detyrimeve.

KREU XXI

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 54

Kontinuiteti i punës së organeve të OIK-së

1. Organet e OIK-së nga përbërja aktuale e Kuvendit vazhdojnë punën deri në konstituimin e organeve nga përbërja e re e Kuvendit.
2. Dëshmitë mbi të kaluarën etike dhe penale nuk duhet të jenë më të vjetra se gjashtëdhjetë (60) ditë nga dita e kërkesës.

Neni 55

Procedura për organizimin e zgjedhjeve të organeve tjera të OIK-së

KQZ, për procedurat e zgjedhjes së organeve tjera të OIK-së, zbaton përshtatshmërisht këto rregulla, për aq sa janë të zbatueshme.

Neni 56

Asgjësimi i materialeve

1. Asnjë procesverbal i KQZ-së, KNJZ-së ose i një komisioni tjetër zgjedhor nuk mund të asgjësohet pa miratimin paraprak të KQZ-së.
2. Të gjitha fletët e votimit asgjësohen sipas mënyrës së përcaktuar nga KQZ-ja.

Neni 57

Interpretimi

Autoritet përfundimtar për interpretimin e rregullave zgjedhore është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Neni 58

Rregullat zgjedhore

1. Pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje janë edhe anekset, si në vijim:
2. 01 - RREGULLORE ZGJEDHORE - EMËRIMI, PËRBËRJA DHE FUNKSIONIMI I KOMISIONEVE TË NJËSIVE ZGJEDHORE DHE KQZ-së
3. 02 - RREGULLORE ZGJEDHORE - KRIJIMI, KUNDËRSHTIMI DHE KONFIRMIMI I LISTËS SË VOTUESVE
4. 03 - RREGULLORE ZGJEDHORE - FLETËVOTIMET

5. 04 - RREGULLORE ZGJEDHORE - VOTIMI, NUMËRIMI NË VENDVOTIM DHE MENAXHIMI I VENDVOTIMIT
6. 05 - RREGULLORE ZGJEDHORE PËR VËZHGUESIT E ZGJEDHJEVE
7. 06 - KODI I MIRËSJELLJES PËR MBËSHTETËSIT E TYRE DHE KANDIDATËT
8. Anekset e përcaktuara nga ky nen mund të ndryshohen me votën e 2/3 të anëtarëve të KQZ-së

Neni 59

Hyrja në fuqi

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen dispozitat e rregullores për organizimin e zgjedhjeve, procedurën e kandidimit, mënyrën e zgjedhjes dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OIK-së me nr. prot. _____ të datës _____, si dhe dispozitat tjera që janë në kundërshtim me këtë rregullore.
2. Formularët përkatës për implementimin e rregullave zgjedhore miratohen nga KQZ.
3. Çështjet të cilat nuk janë të parapara me këtë rregullore dhe legjislacionin e OIK-së rregullohen nga KQZ, në përputhje me standardet, kërkesat dhe praktikën zgjedhore.
4. Kjo rregullore hyn në fuqi nga _____.

Prishtinë _____

Kryetarja e OIK
Nexhmije Gori